



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E POSAÇME E SHKALLËS SË PARË  
PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR

NJOFTIM PËR MEDIAT

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, më datë **28.06.2024** ka paraqitur pranë Gjykatës kërkesën me objekt: “Informacion dy mujor në kuadër të procedimit penal nr.287, viti 2020”.

2. Në përfundim të gjyqimit, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar me trup gjykues të përbërë nga gjyqtarja Irena Gjoka, bazuar në nenet 112, 228, 229, 230, 237, 246 pika 6, 249 dhe 260 të K.Pr.Penale, me vendimin **Nr.400, datë 30.07.2024**, vendosi:

1. Vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në shtëpi**”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale ndaj shtetasit nën hetim **Sali Berisha**, caktuar me vendimin nr. 520, datë 30.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i dyshuar për kryerjen e veprës penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose të zgjedhurve vendorë*”, kryer në bashkëpunim, parashikuar nga neni 260 e 25 i Kodit Penal.
2. Vijimin e zbatimit të masës së sigurimit personal me karakter shtrëngues “**arrest në shtëpi**”, parashikuar nga neni 237 i K.Pr.Penale ndaj shtetasit nën hetim **Jamarbër Malltezi**, caktuar me vendimin nr.56, datë 21.11.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, i dyshuar për kryerjen e veprave penale “*Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërore ose i të zgjedhurve vendorë*”, kryer në bashkëpunimin, dhe “*Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*”, parashikuar nga nenet 260 e 25 dhe 287/2 të Kodit Penal.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 5 (pesë) ditëve, në Gjykatën e Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Tiranë, më datë **30.07.2024**

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar